



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

### Nga dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit të vitit 2021

**Miranda Mullafazliu**, koordinatorë për dëgjimet publike, tha se për shkak të situatës në të cilën ndodhemi, dëgjimet publike i kemi mundësuar përmes platformës ZOOM. Këto dëgjime publike do të mbahen pra nga e hëna deri në ditën e premte, ku qytetarët do të kenë mundësi t'i paraqesin propozimet e tyre buxhetore në fusha të ndryshme.

- 1. Dëgjimi publik, më 24.08.2020, prej orës 10-12:00, që ka të bëjë me sportin, rininë dhe OJQ-të, ku do të bëhet identifikimi i kërkesave të sportistëve, rinisë dhe OJQ-ve për projektet e subvencioneve për planifikimin e buxhetit të vitit 2021.**

E pranishme në këtë dëgjim publik ishte Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave.

**Miranda Mullafazliu** tha se përderisa nuk kemi asnjë propozim të parashtruar nga qytetarët, dëgjimin publik e konsiderojmë të mbyllur.

- 2. Dëgjimi publik, më 25.08.2020, prej orës 11-13:00, që ka të bëjë me drejtorët e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm të Komunës së Prishtinës. Për këtë dëgjim është paraparë identifikimi i kërkesave të çerdheve, arsimit fillor dhe nevojave të nxënësve dhe prindërve për planifikimin e buxhetit të vitit 2021.**

Në këtë dëgjim publikë ishin të pranishëm: **Miranda Mullafazliu**, koordinator e takimeve, **Valbona Makolli**, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, **Shpresa Shala**, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit dhe **Medina Braha**, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

**Miranda Mullafazliu** tha se përderisa edhe sot nuk kemi asnjë kërkesë të parashtruar nga qytetarët, dëgjimin e konsiderojmë të mbyllur.

- 3. Dëgjimi publik, më 26.08.2020, prej orës 11:00 - 13:00, me personelin shëndetësor, QKMF-të QMF-të të komunës së Prishtinës, ku për këtë dëgjim është paraparë identifikimi i kërkesave të personelit mjekësor dhe nevojave të tyre për planifikimin e buxhetit të vitit 2021.**

Prezent në këtë dëgjim janë: **Miranda Mullafazliu**, koordinatorë e takimeve, **Valbona Makolli**, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, **Medina Braha**, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve

Publike, Fatlinda Hoxha, zyrtare në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

Xhavit Buja shtroi pyetjen: Pse nuk punon, pas orës 20:00, Shtëpia e shëndetit në lagjen “Kodra e Diellit”?

**Fatlinda Hoxha**, zyrtare në Drejtorinë e Shëndetësisë, tha se arsyeja që Shtëpi e shëndetit në lagjen “Bregu i Diellit nuk punon edhe në ndërrimin e natës, është se jemi në mungesë të personelit mjekësor, të mjekëve, infermierëve, stomatologut, si dhe për shkak të numrit të shërbimeve që është në rënie e sipër në këtë qendër mjekësore. Me rritjen e stafit mjekësor, do ta funksionalizojmë edhe ndërrimin e natës.

**Fatlum Grisholli**, qytetar, shtroi pyetjen: Pse nuk është bërë asnjë investim në Zonën ekonomike - Orllloviq, ku sipas PZHK-së ajo zonë është e paraparë të jetë zonë ekonomike, ku hyn infrastruktura me ndriçimin e parqeve.

**Medina Braha**, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se ndriçimi publik do të vazhdojë në të gjitha lagjet, pra aty ku mungon, por duhet pasur parasysh se zgjerimi i qytetit po bëhet në vazhdimësi. Ne do të punojmë në atë drejtim dhe do t'i kemi parasysh edhe prioritetet.

Takimi për dëgjimin publik përfundoi në ora 11:45.

**4. Dëgjimi publik, më 27.08.2020, prej orës 11:00 - 13:00, me kryetarët e bashkësive lokale, lagjeve dhe fshatrave të komunës së Prishtinës, ku do të bëhet identifikimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve për planifikimin e buxhetit të vitit 2021.**

**Të pranishëm ishin:** Miranda Mullafazliu, koordinatorë, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve dhe Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

Një qytetar pyeti: Sa është rritur buxheti për përkrahjen e grave në komunën e Prishtinës?

**Valbona Makolli** tha se nga Ministria e Financave kemi marrë një kërkesë, ku thuhet se do të bëhet zvogëlimi i grantit qeveritar, pra nënkupton se nuk kemi ndonjë rritje të buxhetit për përkrahjen e grave.

**Qëndrim Sahiti (INPO)** pyeti: Si ka ardhur ajo kërkesë nga Ministria e Financave?

**Valbona Makolli** tha se pas aprovimit të pakos së parë emergjente, do të bëhen disa shkurtime buxhetore, pra në këtë e kemi marrë si njoftim. Po ashtu, Ministria e Financave, bashkë me kryetarët e komunave janë duke e paraparë mundësinë edhe për një qarkore të dytë.

**Miranda Mullafazliu** tha se “**Ecocos Women**”, një organizatë për zbatimin e projektit “Avokim për qasjen më të lehtë të grave në grante në Komunën e Prishtinës”, ku gjatë aktivitetit që gratë merren me bimë aromatike në Slivovë, kërkojnë ndihmë në sistemin e ujitjes së atyre bimëve.

**Valbona Makolli**, drejtoreshë, tha se këtë kërkesë ne do ta paraqesim në vitin 2021 në drejtorinë përkatëse.

**Fatime Hajdari**, drejtoreshë, tha se si komunë jemi të interesuar me i shtyrë përpara këto veprimtari dhe për me iu ofruar mbështetje asaj organizate, por deri më tani nuk e kemi pasur asnjë kërkesë të tillë. Shpresojmë se në vitin e ardhshëm, pasi që në dispozicion i kemi 200.000 euro, ku dhe do ta kemi parasysh edhe shtrimin e rrjetit të ujitjes dhe hapjen e puseve të reja.

**Besart Peshku**, qytetar, shtroi pyetjen: Në fshatin Barilevë disa hapësira po përdoren vetëm për hedhjen e mbeturinave. Çka do të bëhet me atë zonë dha a është në projekt që të paktën aty të jetë zonë gjelbëruese?

**Medina Braha**, drejtoreshë, tha se aty është deponi ilegale dhe ne si drejtori i largojmë mbeturinat nga vendet ku nuk janë të lejuara të hedhen ato. Kisha sugjeruar që qytetarët t'i denoncojnë keqbërësit qoftë në Drejtorinë e Inspektionit, apo në polici, për ndalimin e këtyre veprimeve ilegale.

**Fatime Hajdari**, drejtoreshë, tha se sa i përket shtimit të zonave gjelbëruese, Komuna e Prishtinës i ka prioritet këto zona. Në fshatin Prugoc do të jetë një park i ri, prandaj në të ardhmen do të punojmë që edhe në zonat tjera të ndërtohen paqe, ku të paktën aty do të vendosen disa ulëse për qytetarë.

Dëgjimi publik përfundoi në orën 12:00.

**5. Dëgjimi publik, më 28.08.2020, prej orës 10:00 - 12:00, me asamblistët e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, ku do të bëhet identifikimi i kërkesave të qytetarëve për planifikimin buxhetor të vitit 2021.**

Në këtë dëgjim prezent janë: Miranda Mullafazliu, koordinatorë, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

**Miranda Mullafazliu** tha se përderisa edhe sot nuk kemi asnjë kërkesë të parashtruar nga qytetarët, dëgjimin e konsideroi të mbyllur.

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**